



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë së Lirisë

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 09.09.2026

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

Z. Tedi Blushi

Deputet, Grupi parlamentar i Partisë së Lirisë

OBJEKTI:

Interpelancë me Ministrin e Financave, Z. Petrit Malaj mbi masat fiskale për uljen e çmimeve, reduktimin e barrës mbi qytetarët dhe mbrojtjen e fuqisë blerëse

BAZA LIGJORE:

Neni 80 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni 96 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

DREJTUAR:

Z. Niko Peleshi

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 96 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj zhvillimin e një interpelance me Ministrin e Financave për të marrë përgjigje të plota dhe konkrete mbi politikat fiskale dhe masat që Qeveria planifikon të ndërmarrë për uljen e çmimeve, reduktimin e barrës fiskale dhe mbrojtjen e fuqisë blerëse të qytetarëve shqiptarë.

Në një kohë kur familjet shqiptare përballen çdo ditë me rritjen e kostos së ushqimeve, karburanteve dhe shpenzimeve bazë të jetesës, politika fiskale e

qeverisë vijon të mos ofrojë një përgjigje proporcionale me përmasën e kësaj barre.

Sipas të dhënave më të fundit të Eurostat, në muajin korrik çmimet e ushqimeve në Shqipëri u rritën rreth 3.2%, kundrejt vetëm 0.6% në Bashkimin European. Pra, ushqimet në Shqipëri **po shtrenjtohen më shumë se pesë herë më shpejt** se mesatarja europiane, ndërkohë që të ardhurat e familjeve shqiptare mbeten shumë më të ulëta se ato të qytetarëve të Bashkimit European.

Kjo situatë bëhet edhe më e rëndë po të kemi parasysh fuqinë reale të konsumatorit. Të ardhurat shqiptare, të korrigjuara sipas fuqisë blerëse, mbeten ndjeshëm poshtë mesatares së Bashkimit European. Për qytetarin shqiptar, një rritje prej disa përqindësh e ushqimeve nuk është një statistikë abstrakte, por një kosto shtesë që paguhet drejtpërdrejt nga buxheti familjar.

Në këto kushte, është e pashpjegueshme që Shqipëria vijon të aplikojë **TVSH 20%** mbi produktet bazë të konsumit, ndërkohë që barra fiskale mbi karburantet mbetet ndër faktorët kryesorë të çmimit final, duke arritur në rreth **60% të çmimit të karburantit**.

Në vend që të përdorë politikën fiskale për të amortizuar goditjen mbi familjet dhe ekonominë, qeveria vijon të mbajë një barrë të lartë tatimore mbi konsumin bazë.

Krahasimi me vendet fqinje është domethënës jo për madhësinë e buxheteve të tyre, por për zgjedhjet që ato po bëjnë në politikën fiskale dhe ekonomike.

Në Greqi, qeveria ka prezantuar një paketë prej rreth 3.5 miliardë eurosh për rritjen e të ardhurave dhe uljen e kostos së jetesës, e cila përfshin ndër të tjera mbështetje vjetore prej 400 eurosh për pensionistët, objektivin për një pagë

minimale prej 1,000 eurosh në vitin 2028, ulje të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe masa tatimore për familjet me tre fëmijë dhe fermerët. Paralelisht, Greqia ka ndërmarrë një nismë kombëtare për uljen e çmimeve në mbi 1,735 produkte, me reduktime mesatare që arrijnë deri në 9.5%.

Edhe Mali i Zi, një ekonomi me përmasa dukshëm më të vogla, ka zgjedhur të ndërhyjë drejtpërdrejt mbi barrën fiskale të karburanteve, duke ulur sërish akcizën për naftën. Si rezultat, çmimi i naftës është ulur në rreth 1.87 euro për litër, ndërsa për produktet bazë ushqimore aplikohet një normë e reduktuar e TVSH-së prej 7%.

Ndërkohë, në Shqipëri, qytetari paguan rreth 2.4 euro për litër naftë, ndërsa në Maqedoninë e Veriut çmimi është rreth 1.59 euro për litër. Diferenca është rreth **41%**, një barrë që transmetohet drejtpërdrejt në koston e transportit, prodhimit, shërbimeve dhe në çmimin e çdo produkti që mbërrin te konsumatori.

Këto të dhëna tregojnë se çështja nuk është nëse Shqipëria ka të njëjtin buxhet me Greqinë apo ekonominë e një vendi tjetër. Çështja është se cilat janë prioritetet e qeverisë shqiptare dhe nëse politika fiskale po përdoret për të mbrojtur qytetarin apo për të rritur më tej barrën mbi të.

Partia e Lirisë ka propozuar konkretisht pezullimin e Taksës së Qarkullimit dhe Taksës së Karbonit, si dhe uljen e TVSH-së për shportën bazë të konsumit nga 20% në 5%. Këto propozime nuk janë abstrakte dhe as të parealizueshme; ato janë instrumente konkrete për të ulur menjëherë koston e jetesës dhe për të rritur fuqinë blerëse të familjeve shqiptare.

Përballë kësaj situate, Ministria e Financave ka detyrimin kushtetues dhe institucional të shpjegojë në mënyrë të plotë, transparente dhe të dokumentuar politikën që po ndjek qeveria.

Për sa më sipër, kërkoj zhvillimin e një interpelance me Ministrin e Financave për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

1. Cilat janë masat konkrete fiskale që qeveria po planifikon të marrë për uljen e çmimeve të produkteve bazë të konsumit dhe mbrojtjen e fuqisë blerëse të familjeve shqiptare?
2. Përse Shqipëria vijon të aplikojë një normë 20% të TVSH-së mbi produktet bazë të konsumit, ndërkohë që vende të rajonit aplikojnë norma të reduktuara për këto produkte?
3. Ndërkohë që Maqedonia e Veriut aplikon 5% TVSH për produktet ushqimore, Mali i Zi 7%, Kosova 8% dhe Serbia 10%, Shqipëria vazhdon të aplikojë 20% TVSH mbi konsumin bazë. Si justifikon Ministria e Financave faktin që një familje shqiptare, me të ardhura dhe fuqi blerëse dukshëm më të ulëta se qytetarët e vendeve të Bashkimit European dhe të rajonit, përballat me një barrë fiskale deri në katër herë më të lartë mbi ushqimet bazë?”
4. A po shqyrton Ministria e Financave uljen e TVSH-së për shportën bazë nga 20% në 5%, sipas propozimit të Partisë së Lirisë? Nëse jo, cilat janë arsyet konkrete fiskale dhe ekonomike të refuzimit?
5. A po shqyrton qeveria pezullimin ose reduktimin e Taksës së Qarkullimit dhe Taksës së Karbonit mbi karburantet, me qëllim uljen e menjëhershme të çmimit të tyre?
6. Përse çmimi i naftës në Shqipëri mbetet ndjeshëm më i lartë se në vendet fqinje, ndërkohë që barra fiskale përbën një pjesë shumë të konsiderueshme të çmimit final?
7. Cila është pesha reale e taksave dhe akcizave në çmimin final të një litri naftë në Shqipëri dhe sa janë të ardhurat vjetore që Buxheti i Shtetit siguron nga këto taksa?

8. Sa do të ishte kostoja buxhetore e uljes së TVSH-së së produkteve bazë nga 20% në 5% dhe sa do të ishte ndikimi i pritshëm i kësaj mase në çmimet për konsumatorin?
9. A ka Ministria e Financave një analizë të ndikimit të rritjes së çmimeve të ushqimeve mbi familjet shqiptare, të ndarë sipas nivelit të të ardhurave dhe fuqisë blerëse?
10. Si e shpjegon qeveria faktin që çmimet e ushqimeve në Shqipëri po rriten me një ritëm disa herë më të lartë se mesatarja e Bashkimit Europian?
11. Cilat janë masat që qeveria ka marrë për të parandaluar që kostot fiskale dhe rritja e çmimeve të karburanteve të transmetohen më tej në çmimet e produkteve dhe shërbimeve?
12. A ka Ministria e Financave një plan konkret për reduktimin e barrës fiskale mbi familjet shqiptare gjatë vitit 2026–2027? Nëse po, cilat janë masat, afatet dhe kostoja e tyre buxhetore?
13. A ka analizuar Ministria e Financave masat e ndërmarra së fundmi nga Greqia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi për uljen e kostos së jetesës dhe barrës fiskale? Cilat prej këtyre instrumenteve mund të përshtaten dhe zbatohen në Shqipëri?
14. Cilat janë masat konkrete që qeveria parashikon për rritjen e pagave dhe pensioneve në raport me rritjen reale të kostos së jetesës?
15. A angazhohet Ministria e Financave të paraqesë një plan të matshëm, me objektiva dhe afate konkrete, për rritjen e fuqisë blerëse të qytetarëve dhe uljen e barrës fiskale mbi konsumin bazë?
16. Në kushtet kur qytetarët shqiptarë paguajnë më shumë për ushqimet dhe karburantet se qytetarët e vendeve fqinje, ndërkohë që kanë të ardhura dukshëm më të ulëta, kush mban përgjegjësi për këtë politikë fiskale dhe cilat janë masat që do të ndërmerren për korrigjimin e saj?

Kjo interpelancë synon të marrë përgjigje të plota dhe të dokumentuara mbi një çështje që prek drejtpërdrejt mirëqenien ekonomike të qytetarëve shqiptarë, sa po bën shteti për të ulur koston e jetesës dhe sa është i gatshëm të përdorë instrumentet fiskale për t'i rikthyer familjeve shqiptare një pjesë të fuqisë së tyre blerëse.

Nuk mjaftojnë deklaratat politike dhe as justifikimet e përgjithshme për inflacionin apo tregjet ndërkombëtare. Qytetarët kanë të drejtë të dinë pse paguajnë më shtrenjtë dhe pse taksohen më shumë se kudo tjetër në rajon dhe çfarë do të bëjë konkretisht qeveria për ta ndryshuar këtë situatë.

Me respekt

Deputeti

TEDI BLUSHI